



Raport

Fushata për regjistrim FALAS për
komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

20 Janar - 15 Mars 2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE	6
LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE	6
PËRMBLEDHJE	7
HYRJE	9
QËLLIMI	9
2. KOMUNAT E VIZITUARA	11
2.1 Komuna e Fushë Kosovës	11
2.2 Komuna e Mitrovicës	13
2.3 Komuna e Obiliqit	15
2.4 Komuna e Ferizajt	16
2.5 Komuna e Gjakovës	17
2.6 Komuna e Kamenicës	18
2.7 Komuna e Podujevës	19
2.8 Komuna e Klinës	19
2.9 Komuna e Lipjanit	20
2.10 Komuna e Shtimes	20
2.11 Komuna e Istogut	21
2.12 Komuna e Pejës	22
2.13 Komuna e Rahovecit	24
PËRFUNDIME	25
REKOMANDIME	26
5 SHTOJCAT	27-39



PARATHËNIE

Të nderuar/a,

Mbrojtja, respektimi dhe promovimi i të drejtave të njeriut është një ndër prioritetet e Qeverisë. Angazhimi i vazhdueshëm i MAPL-së në këtë drejtim ka rezultuar me sigurimin e kushteve për mirëqenien e qytetarëve pa dallim përkatësie etnike.

Një nga objektivat është monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave të njeriut në komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të zbatimit të Strategjive dhe zbatimin e ligjeve, andaj me qëllim të barazisë qytetare dhe integritetit të komuniteteve, MAPL ka realizuar fushatën për regjistrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në gjendjen civile për të përmirësuar situatën dhe për të ndihmuar nivelin lokal për përmbushjen e standardeve evropiane. Bazuar në fushatën, është bërë identifikimi i një numri të konsiderueshëm dhe regjistrimi i tyre në gjendjen civile.

Prandaj, shfrytëzojmë rastin të falënderojmë, kryetarët e Komunave, nënkryetarët, udhëheqësit e administratës, njësitë komunale për të drejtat e njeriut, përfaqësuesit e gjendjes civile, zyrtarë për komunitete dhe kthim, përfaqësuesit e lagjeve, shoqërinë civile, OJQ vendore dhe ato ndërkombëtare dhe të gjithë zyrtarët e involvuar në këtë fushatë, për një angazhim të mirëfilltë dhe që kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme.

Me respekt,

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKK	Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
ARC	Agjensioni për Regjistrim Civil
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
RAE	Rom, Ashkali dhe Egjiptian
DADNJK	Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna
DPTK	Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale
NJDNJK	Njësia për të Drejtat e Njeriut në Komunë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNHCR	Komisioni i lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
KD	Këshilli Danez
OJQ	Organizata Joqeveritare
UD	Udhëzimi Administrativ

LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE

Grafiku 1	Numri i komunave të vizituara për regjistrimin e komuniteteve RAE
Grafiku 2	Numri i të regjistruarve në komuna
Grafiku 3	Komunat të cilat janë në proces të regjistrimit
Grafiku 4	Numri i komunave të cilat janë të gjithë të regjistruar nga komuniteti RAE
Grafiku 5	Numri i komunave të cilat nuk kanë komunitet RAE
Tabela 6	Tabela me të dhënat e gjetura, gjatë fushatës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), gjegjësisht Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në komuna, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse komunale, që nga viti 2009 ka realizuar fushatën për regjistrim falas në muajin prill edhe përkundër faktit që shumica e komunave regjistrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e bëjnë falas gjatë gjithë vitit.

DADNJK që nga tetori i vitit të kaluar ka filluar parapërgatitjet për realizimin e fushatës sensibilizuese për regjistrim FALAS të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Fillimisht është hartuar plani i punës duke specifikuar të gjitha aktivitetet dhe afatet kohore. Konform planit janë realizuar takime koordinuese me akterët relevant si Agjensioni për Regjistrim Civil (ARC), UNHCR-in, OSBE-në dhe OJQ-të që merren me çështjen e komuniteteve “Ballkan Sunflowers”. Gjithashtu, janë hartuar dhe publikuar materialet promovuese me moton, “Realizo të drejtat tua, Regjistrohu”.

Me këtë rast MAPL, u ka dërguar shkresë informuese të gjithë kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës dhe strukturave relevante komunale, për të informuar për fillimin e fushatës për regjistrim falas të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shkresës informuese dërguar komunave ju është bashkangjitur edhe Qarkorja e lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin Civil -MPB e datës 26.03.2014, e cila ju rekomandon zyrtarëve të gjendjes civile për heqjen e gjobave dhe tarifave të tjera për shërbimet e regjistrimit të komuniteteve në fjalë.

Fushata për regjistrimin FALAS të faktit të lindjes dhe regjistrimin e mëvonshëm të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, ka filluar nga data 20 Janar dhe ka zgjatur deri më 15 Mars 2015.

DADNJK në bashkëpunim me zyrtarët komunal dhe OJQ-të komunale, ka përgatit hartën e vendbanimeve të identifikuar ku jeton ky komunitet, si dhe agjendën e vizitave.

Sipas agjendës së vizitave që janë zhvilluar në teren janë identifikuar një numër i konsiderueshëm i të paregjistruarve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në këto komuna: Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Istog, Ferizaj, Fushë Kosovë, Obiliq, Kamenicë, Rahovec dhe Klinë(10 komuna). Ndërsa komunat që janë vizituar dhe nuk kanë probleme me regjistrim janë: Lipjan, Shtime dhe Podujevë (3 komuna).

Komunat tek të cilat nuk është paraqitur nevoja për ti vizituar për arsye se nuk kanë problem të natyrës së tillë (janë të regjistruar) janë: Skenderaj, Novobërdë, Viti, Shtërpçë, Prizren, Gjiilan, Suharekë, Malishevë, Prishtinë, Junik, Mamushë, Deçan, Vushtrri (14 komuna).

Komunat ku nuk jeton komuniteti rom ashkali dhe egjiptian janë: Hani i Elezit, Drenas, Dragash, Partesh, Klllokot dhe Kacanik (6 komuna).

Komunat me komunitetin shumicë serb në Republikën e Kosovës, mbeten të vizitohen me kthimin e Ministrit në Kabinetin e Qeverisë së Kosovës (Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan (5 komuna).

Gjatë takimeve me kryetarët dhe strukturat tjera komunale, nga MAPL-ja është kërkuar që të raportojnë në baza ditore lidhur me ecurinë e fushatës. Nga të gjitha këto komuna të vizituara, vetëm komuna e Kamenicës ka përmblusur kërkesat me raportet ditore dhe pjesërisht edhe komuna e Ferizajt. Komuna e Fushë Kosovës, Obiliqit dhe e Pejës kanë formuar ekipet mobile me qëllim të identifikimit dhe ofrimit të mundësisë për regjistrim në vendbanimet ku jetojnë komunitetet.

Sa i përket gjendjes aktuale në komunat e Republikës së Kosovës, regjistrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, shihet si një hap pozitiv duke i identifikuar personat e paregjistruar të këtij komuniteti gjatë vitit 2015. Megjithatë, problemet dhe sfidat janë tek lëvizjet e tyre nga qytetet dhe shtetet e ndryshme të rajonit, si popull nomad që janë. Pastaj, mos interesimi i tyre për posedimin e dokumenteve të Republikës së Kosovës, interesat e tyre materiale me shtetin serb, mungesa e dokumentacioneve apo fshehja e dëshmimeve me qëllim të regjistrimit të dyfishtë. Problem tjetër paraqet mos zbatimi i nenit 12 dhe 13 të Udhëzimit Administrativ 02/2012 - MPB nga komunat edhe përkundër faktit se Qarkorja e ARC – MPB, krijon parakushte për regjistrim FALAS të mëvonshëm të komuniteteve në mungesë të dokumentacionit.

Një ndër problemet tjera me të cilat ballafaqohen komunat është mungesa e aparatit të sofistikuar për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve.

MOS regjistrimi i komuniteteve në fjalë vjen deri te mos integrimi i tyre në sistemin arsimor, shëndetësor të Republikës së Kosovës dhe nuk janë përfitues të asnjë shërbimi social, ndihme apo asistence sociale. Përfaqësues nga MAPL-ja kanë shpërndarë materiale promovuese për komunat, komunitetet dhe OJQ-të, me moton:

“Realizo të drejtat tua... REGJISTROHU”, me mesazhet: “Për një të ardhme më të mirë, shfrytëzo mundësitë”, “Regjistrohu Falas”, “Edhe ti ke të drejta dhe qasje të barabartë”, “Integrohu edhe ti”, “Regjistro fëmijën tënd”, “Realizo të drejtat tua të garantuara” dhe fletëpalosja me moton “Trashëgimia pronësore e drejtë e barabartë për dy gjinitë”.

Në agjendën e këtyre vizitave ishte edhe Pakoja Ligjore për të Drejtat e Njeriut: Projektligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Projektligji për Barazi Gjinore dhe Projektligji për Avokatin e Popullit, për plotësimin dhe ndryshimin e projektligjeve përmes diskutimit publik në komuna.

Vizitat në komuna kanë filluar me datën 2 shkurt. Fillimisht është vizituar komuna e Fushë Kosovës. Më poshtë ju paraqesim në detaje problemet dhe të arriturat gjatë fushatës në komuna.

HYRJE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka mision avancimin e qeverisjes lokale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, që konsiston në sigurimin e shërbimeve efikase në nivelin komunal dhe sa më afër qytetarëve.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas mandatit që i është dhënë me legjislacionin në fuqi, në vazhdimësi mbështet dhe mbikëqyrë aktivitetet e Komunave.

Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna që nga viti 2009, ka kërkuar nga komunat përmbushjen e obligimeve që dalin nga strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, sidomos nga sektori i regjistrimit.

QËLLIMI

Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna (DADNJK), me qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut, sidomos të drejtës për regjistrimin e faktit të lindjes dhe regjistrimin e mëvonshëm, si segment i rëndësishëm i të drejtave universale të njeriut, realizoi fushatën dedikuar të drejtës për regjistrimin Falas të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE).

DADNJK realizoi këtë fushatë duke iu referuar Planit të Punës, Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe detyrave që dalin nga Plani Aksional për Liberalizimin e Vizave.

2. KOMUNAT E VIZITUARA

2.1. Komuna e Fushë Kosovës, 2 Shkurt 2015

Bazuar në agjendën e Vizitave dhe Planit të Punës për vitin 2015, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datën 2 shkurt ka realizuar vizitën e parë në këtë komunë.


Gjatë takimit përfaqësuesit e MAPL-së takuan Drejtoreshën e Administratës, Udhëheqësen e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, zyrtarin për Kthim, Koordinatorin për të Drejtat e Njeriut, zyrtarin për Regjistrim Civil dhe përfaqësuesin e komuniteteve në lagjen 29. Takimi kishte për qëllim informim lidhur me fushatën për regjistrimin FALAS për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ku u dakorduan për krijimin e lehtësirave për regjistrim FALAS dhe ngritjes së vetëdijesimit për promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës si dhe nga përfaqësuesit e MAPL-së u kërkuan komentet për pakon ligjore për të drejtat e njeriut. Në këtë komunë zyrtarët e MAPL-së, u informuan se deri më datë 02 shkurt 2015 është identifikuar një



02 Shkurt 2015, lagjen 029

familje e cila nuk është regjistruar për arsye të mungesës së dokumentacionit. Familja u vizitua nga zyrtarët e MAPL-së dhe përfaqësuesit e komunës, të cilët zhvilluan një bisedë me kryefamiljarin Gazmend Bajrami, i cili i përket komunitetit rom dhe vjen nga qyteti i Prizrenit. z. Bajrami jeton me bashkëshorten dhe 5 fëmijë nga moshë 3 deri në 13 vjet, të gjithë fëmijët kanë lindur në Kosovë dhe asnjëri nga këta nuk është i regjistruar në gjendjen civile. Gjithashtu dy fëmijët të moshës 13 dhe 9 vjeçar kanë vijuar për një kohë të shkurtër mësimin në strukturat paralele serbe, mirëpo kanë braktisur shkollën për shkak të kushteve të rënda ekonomike.

Familja posedon vetëm një certifikatë të martesës së prindërve të bashkëshortes së z. Bajramit e lëshuar në kohën e ish Jugosllavisë.



Dokumenti ekzistues



Kryefamiljari Gazmend Bajrami, Fushë Kosovë

Duke e parë për së afërmi gjendjen e tyre ekonomike përfaqësuesit e MAPL-së dhe përfaqësuesit komunal u dakorduan që brenda javës të kenë një takim të përbashkët me përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe banorëve të tjerë të paregjistruar, me qëllim të lehtësirave të regjistrimit në gjendjen civile.

Me 6 shkurt 2015, Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Bajram Gecaj, dhe kryetari i komunës së Fushë Kosovës, z. Burim Berisha, vizatuan familjen e komunitetit romë e cila ishte identifikuar si e paregjistruar dhe me gjendjen ekonomike të rënd.



Takimi i përbashkët mes përfaqësuesve të MAPL-së dhe përfaqësuesve komunal

Komuna e Fushë Kosovës, informoi se ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme duke formuar ekipin mobil për procesin e regjistrimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE), në komunitet.

Në këtë proces janë angazhuar edhe shoqëria civile, organizatat jo-qeveritare që merren me çështjen e komuniteteve si dhe akterët tjerë me interes që të ndihmojnë realizimin me sukses të këtij procesi.

Gjatë monitorimit në muajin shkurt janë identifikuar edhe 2 raste të të pa regjistruarave në këtë komunë, të cilët ndërkohë u regjistruan:

- Ahmet Bejzaku 12.06.1997;
- Almire Buzolli 14.04.2000;

Gjithsejtë: janë identifikuar 9 persona, prej tyre janë regjistruar 2, ndërsa të paregjistruar janë 7.

2.2. Komuna e Mitrovicës, 03 shkurt 2015

Në vazhden e vizitave në bazë të agjendës nga përfaqësuesit e MAPL-së është vizituar komuna e Mitrovicës, saktësisht lagja e romëve në të cilën jetojnë afërsisht 300 familje, të gjitha familjet në këtë lagje kanë shtëpi dhe jetojnë në kushte mjaftë të mira.

Gjatë vizitës në këtë lagje u vizitua edhe qendra mësimore për fëmijët, në këtë qendër nxënësit vijnë në mësimin formal dhe joformal, mësimin joformal e ndjekin 200 nxënësit, ndërsa 12 nxënësit vijnë në mësimin e rregullt në klasën e 6, 7, 8 dhe 9.

Nxënësit e komunitetit rom rreth 95 % e tyre ndjekin mësimin në gjuhën serbe dhe janë pjesë e strukturave paralele (duke u arsyetuar se në veri të Mitrovicës përfitojnë më shumë të mira materiale, duke përfshirë edhe shtesat për fëmijë). Ndërsa komuniteti rom që jeton në Mitrovicë janë të siguar nga komuna: strehim, ndihmë sociale, objektet fetare, qendrën mjekësore dhe infrastrukturën rrugore në pjesën më të mirë të qytetit.



*Materialet promovuese në tri gjuhë:
shqip, sërbiisht dhe rome*

Komuniteti rom në këtë lagje është në të njëjtën kohë përfitues i dyfishtë si nga Qeveria e Republikës së Kosovës ashtu edhe nga Serbia. Gjithashtu ndihmohet, mbështetet vazhdimisht nga organizatat ndërkombëtare siç është Këshilli Danez për Refugjatë në Kosovë, i cili mbështetë këtë komunitet në fushën e arsimit, zhvillimit të bizneseve (me biznesin për grumbullimin dhe shtypjen e shisheve të plastikës; floktar; autolarje, rrobaqepësi etj...).



Grumbullimi i shisheve të plastikës



Një pjesë e banimit në lagjen e romëve

Gjatë muajit janar, 2015 kanë migruar 58 familje me 305 anëtar nga ta, 52 nxënës janë larguar nga shkolla.

Personat e identifikuar si të paregjistruar në këtë komunë janë:

1. Ajshe Berisha, e shpërngulur nga qyteti i Obiliqit, posedon dokumente të Serbisë;
2. Tanja Mustafa, 7 vjeçare;
3. Rukije Mustafa 5 vjeçare;

Në një pjesë të lagjes së romëve jetojnë personat e kthyer nga shtetet fqinje si dhe nga qytetet e ndryshme të Kosovës të cilët kanë uzurpuar shtëpitë po në këtë lagje. Gjithsej janë 25 familje me 75 anëtar në kushte mjaft të rënda ekonomike, të cilët nuk posedojnë dokumentacione dhe nuk kanë dëshmi e as dëshmitar që të identifikojnë prejardhjen e tyre për ti plotësuar kushtet për regjistrim, disa nga këto familje janë:

1. Ali DEMIRI, nga Gjakova, para 15 viteve i shpërngulur më herët në Mitrovicë, i cili deklaron se është i regjistruar me 3 fëmijë (14, 13 dhe 7 vjet), në qytetin e Gjakovës, mirëpo nuk posedon dokumente. Fëmijët nuk janë të vaksinuar dhe nuk vijnë në mësimin. Pra, nuk janë të integruar në asnjë fushë të jetës për shkak se nuk ekzistojnë juridikisht.

2. Begzad Belizaku, i shpërngulur nga qyteti i Pejës 5 vite më herët në Mitrovicë. Ka tre (3) fëmijë të paregjistruar, të lindur në Mal të Zi, në Pejë dhe Mitrovicë, Moshë: 5, 4, dhe 1.5 vjeçar.

3. Razë Abazi, e lindur në Mal të Zi, e paregjistruar. Bashkëshorti i shpërngulur nga qyteti i Pejës i paregjistruar dhe një (1) fëmijë, i paregjistruar dhe i pa vaksinuar;



Përfaqësuesi i lagjes 2 korriku



Qendra mësimore në lagjen e romëve

Pas vizitës në lagjen e romëve zyrtarët e DADNJK-së bashkërisht me zyrtarët e komunës së Mitrovicës vizituan edhe disa familje të komunitetit shkallë, të cilët jetojnë në lagjen “2 Korriku”. Përfaqësuesi i lagjes informoi se i gjithë komuniteti ashkali posedojnë dokumente të Republikës së Kosovës.

Të rinjtë e këtij komuniteti vijnë në mësimin pa asnjë problem, ka nga ata që kanë përfunduar shkollën e mesëm (25 nxënës) dhe fakultetin (12 student), mirëpo nga 35 familje që jetojnë në këtë lagje asnjë nuk është i punësuar.

2.3 Komuna e Obiliqit, 04 shkurt 2015



Udhëheqësi i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Avni Sahiti informoi kryetarin e komunës z. Xhafer Gashi, lidhur me fushatën për regjistrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe Pakon Ligjore për të Drejtat e Njeriut.



Qendra mësimore, fshati Plemetin

Përfaqësuesit e MAPL-së, u informuan se në këtë komunë përveç të të paregjistruarve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të paregjistruar ka edhe të komunitetit serb, si dhe u kërkua që në të ardhmen edhe këtij komuniteti t'i mundësohet regjistrimi.

Pas përfundimit të takimit të përbashkët me zyrtarët komunal u vizituan disa familje në fshatin Plemetin dhe dy qendra mësimore edukative.

Në fshatin Plemetin fillimisht u vizitua familja e znj. Halide Galiq, e regjistruar, ndërsa 3 fëmijët e saj të paregjistruar të moshës 7, 5 dhe 3 vjeç (në mungesë të kurorëzimit me bashkëshortin). Janë identifikuar të pa regjistruar edhe katër (4) fëmijët e kryefamiljarit Behxhet Nezirit. Gjithashtu u vizitua edhe fshati Janivodë, ku 12 fëmijë janë të paregjistruar të cilët mësimin e vijnë në gjuhën serbe, gjithsejtë janë 19 persona të paregjistruar deri në fund të muajit shkurt.

Mirëpo, si rezultat i monitorimit të fushatës deri me 15 mars 2015, kanë arritur të regjistrohen 22 persona të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

2.4. Komuna e Ferizajt, 10 shkurt 2015

Në vazhden e planit dhe agjendës së MAPL-së për identifikimin e të pa regjistruarve është vizituar edhe komuna e Ferizajt. Si rezultat i fushatës së zhvilluar në këtë komunë zyrtarët përgjegjës komunal kanë identifikuar 27 persona të paregjistruar.

*Zëvendësministri i
MAPL-së z. Gecaj
dhe Kryetari i
Komunës
z. Svarqa*



Komuna e Ferizajt për pasojat e migrimit ilegal në shtetet e Bashkimit Evropian ka realizuar disa spote televizive të cilat janë transmetuar edhe në radiot lokale, në ueb –faqen komunale si dhe rrjetet sociale. Migrimi ilegal ka filluar nga komuna e Ferizajt, ku fillimisht janë larguar komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjatë monitorimit të fushatës janë regjistruar 5 persona, ndërsa 9 janë ende të paregjistruar, 13 persona nuk kanë dokumentacion, arsyeja është që këta 13 persona vijnë nga Republika e Shqipërisë.

MAPL në bashkëpunim me përfaqësuesin e zyrës komunale për Komunitete dhe Kthim, Koordinatorin e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe zyrtarin e Gjendjes Civile, kanë arritur ti grumbullojnë informatat e personave të cilët kanë hasur në vështirësi për mos regjistrimin e tyre në zyrën e gjendjes civile në këtë komunë:

- Mos zbatimi i nenit 12 dhe 13 të Udhëzimit Administrativ 02/2012 - MPB nga komunat edhe përkundër faktit se Qarkorja e ARC-MPB, krijon parakushte për regjistrim FALAS të mëvonshëm të komuniteteve në mungesë të dokumentacionit.
- Sipas informacionit nga përfaqësuesi i zyrës së gjendjes civile në komunën e Ferizajt, regjistrimi i mëvonshëm parasheh marrjen e gjurmëve të gishtërinjve në mungesë të dokumentacionit, gjë të cilën kjo zyre nuk ka kompetenca dhe pajisjet e nevojshme e as ekspertizën për këtë (megjithëse ata bëjnë të pamundurën që palët të regjistrohen).

5 persona të regjistruar

Personat e regjistruar gjatë fushatës janë si në vijim:

1. Hanife Dema e lindur me 25.03.1938;
2. Elmedin Ramadani I lindur me 27. 04. 2014;
3. Gjenet Berisha;;
4. Kadife Ramadani e lindur me 18. 10. 2014;
5. Osman Dema;



Takimi me kryetaren e Gjakovës, znj. Kusari Lila

2.5. Komuna e Gjakovës, 11 shkurt 2015

Fushata për regjistrim FALAS për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, është zhvilluar edhe në komunën e Gjakovës. Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Bajram Gecaj, Sekretari i Përgjithshëm z. Besnik Osmani dhe zyrtarët e DADNJK-së, njoftuan kryetaren e komunës së Gjakovës znj. Mimoza Kusari-Lila, lidhur me ecurinë e fushatës.

Gjatë takimit znj. Lila, informoi se në komunën e Gjakovës janë bërë parapërgatitjet për fushatën sensibilizuese. Në këtë komunë jetojnë 5% e qytetarëve të komunitetit egjiptian, 1% komunitetit rom dhe 1% komunitetit ashkali. Në komunë jetojnë një numër i madh i shqiptarëve të ardhur nga Shqipëria të cilët janë të integruar në sistemin arsimor si dhe zhvillojnë biznese të ndryshme të cilët kanë bërë kërkesë për shtetësi (në të ardhmen do të gjinden modalitete për regjistrimin e tyre).

Pas takimit në mes përfaqësuesve të MAPL-së dhe kryetares së komunës së Gjakovës dhe OJQ-ve lokale, vizita vazhdoi në lagjen Sefa në qendër të qytetit ku jetojnë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian , ku edhe u shpërndanë materialet promovuese.

Në këtë lagje janë identifikuar një vajzë dhe një familje (6 anëtarë) të pa regjistruar të cilët u njoftuan për procedurat lehtësuese për regjistrim të më vonshëm.

13 persona të regjistruar

Gjatë monitorimit të fushatës janë regjistruar :

1. Myzaqete Hasi 30.01.2015,
2. Arjana Cufa 26.04.2004,
3. Pajim Morina 21.01.2015,
4. Arbiana Podrimja 10.05.2013,
5. Suzana Rankoviq 06.05.1963
6. Fridon Berisha 27.01.2015
7. Edison Ibrahim 14.05.2003,
8. Anila Maliqi 04.02.2015,
9. Armend Cigani 02.08.1994,
10. Gjemail Cigani 30.09.1996,
11. Hana Idrizi 03.01.1993
12. Emran Amurllahu 01.01.1998
13. Egzon Gashi 11.03.2003

Pra , të regjistruar janë 13 persona, ndërsaq të paregjistruar 7 persona.

2.6. Komuna e Kamenicës, 13 shkurt 2015



Shpërndarja e materialeve promovuese nga Zv. Ministri Gecaj

Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z. Bajram Gecaj, u prit nga kryetari i komunës së Kamenicës, z. Begzad Sinani, nga i cili u njoftua për vijueshmërinë e fushatës sensibilizuese për regjistrimin e faktit të lindjes si dhe regjistrimin e më vonshëm të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjatë takimit u njoftua se në komunën e Kamenicës jetojnë gjithsejtë 520 banorë të komunitetit rom në lagjen Çamëria. Prej tyre të paregjistruar janë 8 persona në mungesë të dokumentacionit:

1. Miroslav Arsiq;
2. Drone Xhaka;
3. Tefik Rexhepit (mbesa e tij nuk është e regjistruar);
4. Janë 5 gra të familjes së: Sadik Halil, Qenan Kryeziu, Avdi Kamberi, dhe Miftar Kryeziu, këto gra nuk janë të regjistruara sepse janë nga komuna e Vranjës, Beogradit dhe Bujanocit.

Zëvendës kryetari i kësaj komune kërkoi nga MAPL-ja që t'i mundësohet regjistrimi edhe i komunitetit serb që jetojnë në këtë komunë.

Zëvendësministri z. Gecaj dhe kryetari z. Sinani, bashkërisht vizituan familjen rome në fshatin Strezoc, ku përgjegjësit komunal kishin identifikuar dy fëmijë të paregjistruar të familjes në fjalë.

Gjatë monitorimit të fushatës nga zyrtarët përgjegjës komunal janë identifikuar gjithsej 12 persona, ndërsa kanë arritur të regjistrohen vetëm (1) person, të tjerët janë në procedurë. Komuna e Kamenicës është e vetmja komunë e cila ka raportuar çdo ditë në MAPL për ecurinë e fushatës.

2.7. Komuna e Podujevës, 16 shkurt 2015

Zëvendësministri z. Bajram Gecaj si dhe zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, vizituan komunën e Podujevës, për tu informuar për vijueshmërinë e fushatës në këtë komunë.

Kryetari i komunës z. Agim Veliu, njoftoi përfaqësuesit e MAPL-së, se në këtë komunë të gjithë pjesëtarët e këtij komuniteti janë të regjistruar dhe nuk ka probleme të natyrës së tillë.

Sipas statistikave në komunën e Podujevës jetojnë 910 pjesëtar të këtij komuniteti dhe 5 serb. Të gjithë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë të regjistruar dhe mjaftë mirë të integruar në të gjitha sferat e jetës, njëjtë si komuniteti shumicë.



Takimi në komunën e Podujevës,

Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim ofroi raportin me të dhëna për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian ku: nxënësit e shkollës së mesme janë të gjithë përfitues të bursave, ndërsa fakultetin e vijnë 7 studentë (4 meshkuj dhe 3 femra), të gjithë nxënësit mësimin e ndjekin në gjuhën shqipe (në shkollë fillore janë 154 nxënës dhe në shkollë të mesme 22).

2.8. Komuna e Klinës, 23 shkurt 2015



Takimi me përfaqësuesit e komuniteteve REA, Klinë

Fushata vazhdoi me komunën e Klinës, ku përfaqësuesit e MAPL-së u njoftuan lidhur me fushatën për regjistrim FALAS. Të pranishëm ishin strukturat komunale, organizatat ndërkombëtare si: UNMIK-u, OSBE, OJQ-të dhe përfaqësuesit e lagjeve ku jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian .

Me këtë rast është adresuar edhe çështja e pakos ligjore për të drejtat e njeriut, ku nivelit komunal ju është dhënë mundësia e ofrimit të komenteve.

Komuna e Klinës u dakordua për angazhimin maksimal dhe koordinimin e aktiviteteve gjatë monitorimit të fushatës, gjithashtu, përfaqësuesit e MAPL-së u njoftuan se në

komunën e Klinës jetojnë 2170 pjesëtarë të komuniteteve rom, prej të cilëve kanë migruar 180 persona.

Kërkesa e përfaqësuesit të ZKKK-së, ishte regjistrimi i komunitetit serb dhe shqiptar të cilët janë të paregjistruar. Gjatë monitorimit të fushatës kanë identifikuar katër (4) fëmijë të paregjistruar të kthyer nga Mali i zi.

2.9. Komuna e Lipjanit, 24 shkurt 2014



Takimi me përfaqësuesit e komuniteteve REA, Klinë

Përfaqësuesit e MAPL-së vizituan komunën e Lipjanit, ku u pritën nga Koordinatorja e NJDNJK-së, e cila na njoftoi se të gjitha komunitetet në komunë janë të regjistruar, për arsye se gjatë gjithë vitit regjistrimi është falas.

Udhëheqësja e Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut, informoi të pranishmit për fushatën dhe kërkoi që ekipet në teren të përhapin informacionin dhe shpërndarjen e materialit promovues, me qëllim të identifikimit të ndonjë rasti të paregjistruar. Po ashtu u vizitua edhe Shefi i zyrës së gjendjes civile, i cili informoi për procedurat lehtësuese që aplikohen gjatë tërë vitit me rastin e regjistrimit të komuniteteve.

2.10. Komuna e Shtimes, 24 shkurt 2015

Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal z. Gecaj, u prit nga kryetari i komunës, njëkohësisht Kryetar i AKK, z. Naim Ismajli, i cili u njoftua për fushatën për regjistrimin falas për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian si dhe për pakon ligjore për të drejtat e njeriut.

Në komunën e Shtimes nuk ka asnjë të paregjistruar, sepse që nga pas lufta komform Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes komunës dhe organeve kompetente janë liruar nga pagesa për të gjitha shërbimet duke përfshirë regjistrimin. Vetëm në 2 muajt e fundit të vitit 2015, komunitetet janë pajisur me 53 dokumente të ndryshme.



Takimi me kryetarin e komunës së Shtimes

Zëvendësministri i MAPL-së, z. Gecaj ka vizituar qendrën arsimore në fshatin Gjyrkovc, ku janë takuar me përfaqësuesit dhe familjar të lagjes. Ata vlerësuan lartë bashkëpunimin mes administratës komunale dhe kësaj qendre duke potencuar se falë bashkëpunimit këto komunitete janë të integruara plotësisht dhe njëherit janë të barabartë me komunitetin shumicë.

Sipas statistikave që posedon përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim, në komunën e Shtimes jetojnë 750 ashkali, 20 rom, nga këta 150 nxënës që vijnë në mësimin nga klasa e parë (1) deri në klasën e nëntë

(9) si dhe shkollën e mesme vijnë 16 nxënës.

Gjithashtu u përmendën edhe një sërë aktivitete që ka bërë komuna siç janë në vijim :

- Vizita shtëpiake;
- Trajtime shëndetësore nëpër lagje;
- Integrimi i tyre në shkolla;
- Mësimi shtesë për ata nxënës që kanë mbet mbrapa me vite, me arritjen e suksesit ju janë bashkuar gjeneratës së tyre.
- Programe për arsimin e femrës;
- Integrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në jetën kulturore etj...

2.11. Komuna e Istogut, 25 shkurt 2015



Takim me kryetarin e Komunës së Istogut

Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z. Bajram Gecaj, u prit nga kryetari i komunës z. Haki Rugova, i cili njoftoi rreth problemeve për mos regjistrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në tre vitet e fundit në këtë komunë regjistrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është falas. Problemet me të cilat ndeshet komuna është mos harmonizimi i infrastrukturës ligjore si dhe marrja e dokumenteve nga jashtë.



Vizitë në fshatin Bajë, Istog

Kryetari z. Rugova, shprehi gatishmërinë se për ato familje të cilat nuk kanë mundësi financiare ti marrin dokumentacionin nga shtetet fqinje, është i gatshëm për të gjitha shpenzimet e rrugës dhe të dokumenteve të mbulohen nga komuna.

Përfaqësuesit kompetent për fushatën kanë identifikuar 4 raste të paregjistruar, 4 raste në procedurë të regjistrimit, si dhe 7 raste të regjistruara në muajin shkurt.

Përfaqësuesit e MAPL-së dhe përfaqësuesit e komunës vizituan familjen e Skender Mashollit në fshatin Bajë, i cili i përket nacionalitetit rom. Zyrtarët komunal e njoftuan më gjerësisht për mundësinë e regjistrimit të dy fëmijëve të moshës 5 dhe 6 vjeçare.

Që të gjithë janë të lindur në Tivat të Malit të Zi. Andaj, për personat e lartpërmendur, është ofruar gatishmëria nga kryetari i Komunës, z. Rugova që gjatë javës së parë të marsit t'iu sigurohet transporti i prindërve deri në Mal të Zi, ku përcjellës i tyre do të jetë Koordinatori për Kthim të Qëndrueshëm.

Në kuadër të aktiviteteve për regjistrim të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë regjistruar me procedurë lehtësuese për 3 fëmijë.

1. Desjan Ukaj 17.11.2012 - Istog
2. Kelmend Ukaj 15.06.2006 - Istog
3. Daim Ukaj 20.04.2009 - Istog

Komuna e Istogut vazhdimisht ka bërë fushatën dhe është përpjekur maksimalisht që t'i evidentoj të paregjistruarit.

4 persona të pa regjistruar

Gjatë monitorimit të fushatës janë identifikuar edhe katër (4) raste të pa regjistruar, emrat e të cilëve janë:

1. Kastriot Naim Ukaj;
2. Liridone Naim Ukaj;
3. Floreta Afrim Ukaj;
4. Denis Afrim Ukaj.

2.12. Komuna e Pejës, 25 shkurt 2015



Takimi i përbashkët në komunë e Pejës

Komuna e Pejës pas marrjes së shkresës nga MAPL-ja për fushatën e regjistrimit FALAS, përmes radios lokale ka njoftuar komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian se regjistrimi FALAS ka filluar dhe mund t'i drejtohen zyrës së gjendjes civile.

Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z. Bajram Gecaj, u njoftua për procesin e regjistrimit të fushatës nga kryetari z. Gazmend Muhaxheri. Përfaqësuesit përgjegjës të komunës sipas



Lagje "7 shtatori" Pejë

Urdhëresës së ARC-ës në kuadër të MPB-së kanë identifikuar personat e paregjistruar të cilët janë banorë të Republikës së Kosovës por jetojnë në Mal të Zi.

Sipas marrëveshjes që ka Kosova me Malin e Zi, kjo komunë gjatë vitit 2014 ka lëshuar 200 ekstrakte të lindjes të cilat dokumente janë dërguar në Mal të Zi dhe si proces është ende në vazhdimësi.

Komuna e Pejës në këtë periudhë ka informuar komunitetin RAE përmes fushatave sensibilizuese dhe tryeza të ndryshme për regjistrim, me këtë rast kanë arritur të regjistrohen 14 persona në tre muajt e fundit.

Ndërsa sa i përket strehimit komuna në bashkëpunim me UNHACR-in kanë ndërtuar 10 shtëpi. Kryesisht këto familje janë vendas të fshatit Nakëlla, dhe 6 shtëpi në proces të ndërtimit për të kthyerit e këtij komuniteti nga vendet tjera.

Përfaqësuesit e MAPL-së, së bashku me përfaqësuesit e komunës vizituan lagjen "7 Shtatori", gjatë kësaj vizite kanë identifikuar një familje prej 8 anëtarëve, të cilët jetojnë në kushte të mjerueshme ekonomike si dhe të pastrehuar.

Kryetari i komunës z. Muhaxheri shprehu interesimin për mbështetje për këtë familje, fillimisht strehimin (shtëpi), mundësinë e regjistrimit, rregullimin e infrastrukturës rrugore në këtë lagje, si dhe largimin e deponisë së madhe të mbeturinave.

Me datë 12 mars 2015 Zëvendësmministri z. Gecaj ka vizituar prapë komunën e Pejës për përgatitjet për ndërtimin e tri shtëpive të familjeve në nevojë (njëra është familja e cekur më lart), përmes angazhimit të përbashkët të Komunës së Pejës, Zyrës së Kryeministrit për Komunitete, dhe Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve.



Shpërndarja e fletëpalosjeve në komunën e Rahovecit

1.13. Komuna e Rahovecit, 26 shkurt 2015



Përfaqësuesit e Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna (DADNJK), kanë vazhduar vizitën në bazë të agjendës në komunën e Rahovecit.

Gjatë takimit Koordinatorja e NJDNJK-ës njoftoi se Kryetari i komunës ka nxjerr një vendim, që të gjitha shërbimet komunale të jenë falas për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, (përveç atyre që janë në kushte të mira ekonomike). Gjithashtu lidhur me implementimin e Planit Lokal për Integrimin e komuniteteve komuna, konkretisht koordinatori ka përfutur projektin për

aftësimin profesional për 10 persona të komuniteteve RAE. Ky aftësim profesional është për disa drejtime si: saldim, floktar, automekanik, bujqësi etj... Në këtë projekt përfutuesit pajisjen me certifikata, pastaj ju blihen pajisjet në vlerë prej 1400 euro për të filluar bizneset në të cilat ata janë aftësuar. Projekti është fituar falë reagimit të komunës për shqetësimin e migrimin të tyre në vendet perëndimore.

Sipas statistikave që posedon komuna, përafërsisht jetojnë 700 rom, ashkali dhe egjiptian, 2 nga të cilët janë identifikuar si të pargjistruar.



Bazuar në informacionin e grumbulluar gjatë takimeve me përfaqësuesit komunal dhe vizitat në teren, gjegjësisht në vendbanimet ku jetojnë komunitetet, konkludojmë se institucionet e vendit punojnë në vazhdimësi për mbledhjen e të dhënave të sakta, për të identifikuar individët apo familjet që janë të peregjistruara. Nga këto familje/individ të vizituar një numër i vogël me gjendje të rëndë ekonomike. Organet përgjegjëse duhet të ndërmarrin hapa për përmirësimin e kushteve të jetës, strehimit, regjistrimit, ofrimit të kushteve për edukim, aftësim dhe riaftësim profesional, punësim dhe sidomos për ato familje që kanë nevojë për trajtim shëndetësor.

Sipas të dhënave nga raportet e komunave gjendja është kjo:

- Të identifikuar 233 persona;
- Janë regjistruar 90 persona;
- Të peregjistruar janë 55 persona;

Ndërsa, 88 persona janë të ardhur nga vendet e ndryshme rajonale (si të peregjistruar në Mitrovicë 75 Rom dhe 13 persona Shqiptar të Shqipërisë në Ferizaj).


Nëse llogaritet edhe ky numër atëherë të identifikuar janë: 233




Rekomandimet

- 1** Evitimi i pengesave për zbatimin e nenit 12 dhe 13 të U.A. 2012/02 dhe Krijimi i kushteve për regjistrimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në gjendjen civile, regjistrimi i faktit të lindjes dhe regjistrimi i më vonshëm;
- 2** Ofrimi i kushteve për strehim për familjet që jetojnë në varfëri ekstreme sidomos në komunat:Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore dhe Pejë;
- 3** Shpërndarja e ndihmës sociale dhe pakos stimuluese për të gjithë personat në nevojë pa dallime etnike;
- 4** Koordinim i ngushtë mes shoqërisë civile, OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare me përfaqësuesit komunal për identifikimin e familjeve në gjendje të mendë ekomomike dhe ofrim më efektiv të shërbimeve të ndryshme;
- 5** Të mbështeten projekte dhe iniciativat tjera për përmirësimin e jetës së këtij komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian;
- 6** Të harmonizohen dokumentet e nxjerra për regjistrimin falas për komunitetin RAE me objektivat e Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve në mënyrë që të jenë lehtë të zbatueshme;
- 7** Bashkëpunimi dhe koordinimi në mes MPB, ARC, CRK ,MAPL-së, komunave, dhe OJQ-ve lokale dhe ato ndërkombëtare, për realizimin e të drejtave të njeriut, gjegjësisht të të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE



Grafiku 1:
Numri i të
identifikuarve për
regjistrim FALAS




Grafiku 2:
Numri i të
regjistruarve në
komuna

Numri më i madh i identifikuar si të paregjistruar është në Mitrovicë, mirëpo këto familje nuk kanë asnjë dëshmi sepse janë të ardhur nga shtetet fqinje, shumica të ardhur në tri vitet e fundit. Gjithsej janë 25 familje me 75 anëtar. Ndërsa 13 persona janë të paregjistruar në komunën e Ferizajt që i përkasin komunitetit Shqiptar nga Shqipëria. Gjithashtu edhe në komunën e Gjakovës ka një numër të madh të qytetarëve të ardhur nga Shqipëria.

Ky numër nuk është i paraqitur në grafik.



Grafiku 3:
Komunitet të cilët janë në proces të regjistrimit të komuniteteve RAE



Grafiku 4:
Numri i komunave të cilat janë të gjithë të regjistruar nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët nuk kanë probleme

Grafiku 5:

Numri i komunave të cilat nuk kanë komunitet rom, ashkali dhe egjiptian




Tabela 1: Tabela me të dhënat e gjetura, gjatë fushatës

Monitorimi i fushatës për regjistrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian				
Komunat	Të identifikuar	Të regjistruar	Të pa regjistruar	Probleme në regjistrim, personat e zhvendosur nga vendet fqinje
SHTIME				
PRIZEREN	18	18		
FUSHË KOSOVË	9	2	7	
OBILIQ	22	19	3	
PODUJEVË				
MITROVICË JUGORE	78		3	75
VUSHTERRI				
SKENDERAJ				
FERIZAJ	27	5	9	13
LIPJAN				
MALISHEVË				
DRENAS				
PRISHTINË				
NOVOBERDË				
KAMENICË	15	3	12	
GJILAN				
RAHOVEC	2		2	
GJAKOVË	24	13	11	
DECAN				
KAÇANIK				
VITI				
DRAGASH				
PEJË	14	14		
ISTOG	11	7	4	
KLINË	4		4	
SUHAREKË	1	1		
SHERPCË	2	2		
JUNIK	6	6		
HANI I ELEZIT				
MAMUSHË				
GRAQANICË				
PARTESH				
MITROVICA V.				
RANILLUK				
KLLOKOT				
Totali	233	90	55	88

Sipas të dhënave nga raportet e komunave gjendja është kjo:

- Të identifikuar 233 persona;
- Janë regjistruar 90 persona;
- Të paregjistruar janë 55 persona;

Ndërsa, 88 persona janë të ardhur nga vendet e ndryshme rajonale (si të paregjistruar në Mitrovicë 75 Rom dhe 13 persona Shqiptar të Shqipërisë në Ferizaj).

Nëse llogaritet edhe ky numër atëherë të identifikuar janë: 233

6.SHTOJCAT

- Shtojca 1. fletëpalosja“ Realizo të drejtat e Tua... Regjistrohu”
- Shtojca 2. fletëpalosja“ Trashëgimia pronësore e drejtë e barabartë për dy gjinitë”
- Shtojca 3. Baneri në tri gjuhë
- Shtojca 4. Bluza “ Regjistrohu”
- Shtojca 5. Plani i Punës për regjistrimin e komuniteteve RAE në komuna
- Shtojca 6. Plani i vizitave
- Shtojca 7. Letër njoftuese nga MAPL
- Shtojca 8. Letër qarkore e ARC/MPB

Shtojca 6.1 Fletëpalosja “Regjistrohu”



**Realizuj
svoja zagarantovana
prava**

Registruj se

ADRESA: ZGRADA BIVŠE RILINDJE
SPRAT XI
10000 PRISTINA, REPUBLIKA KOSOVA

Uprava za performansi i transparentnost opština
Sektor za unapredjenje ljudskih prava u opštinama

www.mapl.rks-gov.net



Registruj se

E Kosovaki Republikaki Konstituciya pasharla bereberune hakya vash savore dizutne bizo nilyekh forma e diskriminipeski.

Krisi upral o rashtripe garantinena hakya e savore qhavoreng kola biyangyona ani Kosovaki republika kay te registringyon bi lelo pe konsideripe e sahperiodesko beshipasko thanesko olenge daya/dadengo.

BIZO POKIPE!



Te sine kay Tu vash varesavo sebero na siyan registrimo vay na registringyan tere qhavore ji akana, vastin toro hako kova garantinyola e Kriseya vash o Civilyni Situaicia, te sine kay na sito dokumanta, le yekhe ispatyune jene thay nak ani tiri komuna kote si o ofiso vash civilyni situaicia kote Tu manglape te registreine o biyanipe e foshnako, prandipe thay meripe e som jengengo tara familiako.

Registripe e fakesko odova e biyanipesko si BIZO POKIPE e akava kergya shaipe e Ministria vash Androne Bukya upral yekh Cirkularuno Li e Agenciako vash Civilyni Registripe, cidipe e joba thay tarifa vash resurso e civilyni situaiciao vash komunitetya Roma, Ashkaliye thay Ejiptasya.

Registrin tara foshna kay te ovelola rashtipe thay te therol savore garantime hakya, bereberune e savore yavere dizutnencar, rashtyune e Kosovaka Republikaka.

Ini Tu tu situ hako thay bereberuno ascekpto ano:

- Jivdiipe, identiteti, tromalipe thay siguria;
- Ano nav thay rashtripe;
- Siklripe thay sar sakanutno edukipe;
- Evolviripe e karierako thay personaluno kualifike;
- Ano leipe pe buti, pokipe thay ashlipe;
- Ano garavipe thay sastipeske resursya, familiako planifikipe;
- Te phane o prandipe, niqanluko thay te kreirine familia e bereberuno prandipasko barvalipe;
- Ano kustikipe e barvalipesko ano suro e rumipesko e niqalukosko vay meripe e romesko/romnyako;
- Ano sistemi e siguriako thay socialuno shukarhalovipe;
- Ano kreiripe, dikhipe thay garavipe e shukarhalovi pesko e qhavengo thay familiako...
- Ano jivdiipe politkuno thay publikuno;
- Ano votuip, alosaripe sar ini te ove alosardo/i, ano savore rashtyune organya alosardo publikipea;
- Ano hramipe thay imlementipe e rashtune politkengo;
- Ano adikeripe e publikune poziciengo thay phiravipe e savore publikune funkciengo ano savore guvernipeske nivela;
- Ano makro thay mikro programya - ekonomikune, finciarune, privatizmo thay mangin;
- Ano ulavde sheya vash takyaripe e kreiripesko e biznisyengo thay korkoro theripe buti;
- Ano krisiyuno dogryuno proceso thay ano bizorigyuno.

Odoleske integringyov ini TU

REGISTRINGYOV yekhtar kay te realizine tere garantime hakya! Vash realizipe vay ushkavipe tere haknyengo direktinyov ko komunalune strukture:

Komunaluno organi vash manushikane hakya/ ofiseri vash o komunitetyenge hakya; Komunaluno ofiso vash komunitetya thay iranipe;

Yaveruno sheruno vash komunitetya Talosheruno vash komunitetya thay Komiteti vash komunitetya



Registrin tumara foshna!

Shtojca 6.2 Baneri në tri gjuhë



Shtojca 6.3 Bluza “Regjistrohu”



Shtojca 6.4 Fletëpalosja “Trashëgimia pronësore e drejtë e barabartë për dy gjinitë”

Kush janë TRASHËGIMTARËT LIGJORË?

Trashëgimtarë ligjorë janë: **fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit, motrat dhe pasardhësit e tyre.**

Si ndahet pasuria trashëgimore kur vdes njëri nga bashkëshortët?

Pasuria trashëgimore e të vdekurit trashëgohet para të gjithëve nga fëmijët dhe bashkëshorti/ja i/e të vdekurit.

Këta trashëgojnë pjesë të barabarta dhe paraqesin radhën e parë të trashëgimisë. (fjala bashkëshort dhe trashëgimlënës përdorur këtu nuk paragjykon gjininë, dmth, vlen njësoj si për gjininë femërore ashtu edhe për atë mashkullore.

Gjithashtu, fëmijë nënkuptojnë djemtë dhe

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministardre Administratje Lokale/Samoprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti për Performancë dhe Transparençë Komunale
Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komunë

TRASHËGIMIA PRONËSORE E DREJTË E BARABARTË PËR TË DY GJINITË

Mos lejo që të tjerët ti shkelin të drejtat e tua!

Paqja dhe zhvillimi shoqëror kërkojnë një sistem në të cilin e drejta në trashëgimi pronësore, respektohet dhe pasuria ndahet në mënyrë të plotë, pavarësisht se a është fjala për vajzën apo për djalin.

Barazia në trashëgimi pronësore dhe isurisë, është atëherë kur e trashëgimisë pronësore ie të tjera materiale, nënryrë të barabartë si për fjalim.

Fëmijët si trashëgimtar!

Fëmijët duhet të trajtohen barabartë në ndarjen e pasurisë së trashëgimisë!

Fëmijët e lindur në martesë, jashtë martesë, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent, si dhe ata të adoptuar dhe pasardhësit e tyre, kanë të drejtë të barabarta në pasurinë e trashëgimlënësit.

Fëmija i adoptuar dhe pasardhësit e tij ndaj adoptuesit, kanë të drejtë të barabarta trashëgimore sikurse fëmijët e adoptuesit dhe pasardhësit e tjerë të tij.

Trashëgimia tek personat që bashkëjetojnë?

Burri dhe grua që bashkëjetojnë në një bashkësi jashtë martesore mund të trashëgojnë njëri-tjetrin si bashkëshortë, nëse:

a. Bashkësia jashtë martesore deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ka zgjatur të paktën 10 vjet, e nëse nga kjo marrëdhënie ka zgjatur për periudhën 5 vjeçare dhe gjatë bashkë jetesës kanë lindur fëmijë;

b. Në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, asnjëri nga personat që kanë bashkëjetuar të mos ketë qenë ligjorësi i martuar me ndonjë person të tretë, ose nëse trashëgimlënësi ka qenë ligjorësi i martuar me personin e tretë dhe ka paraqitur padi për shkurorëzim ose nulim të martesës dhe pas vdekjes së tij konstatohet se padia ka pasur mbështetje.

Personat që kanë bashkëjetuar nuk konsiderohen si trashëgimtarë të domosdoshëm.

Personi që ka bashkëjetuar nuk ka të drejtën e trashëgimisë në pasurinë e trashëgimlënësit nëse nuk ka bashkëjetuar për periudhën kohore të cekur nën paragrafin a.

Si fitohet trashëgimia?

Trashëgimia fitohet me ligj ose me testament. Trashëgimia me ligj fitohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose e ka lënë me testament vetëm një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

Trashëgimtarët, femra dhe meshkuj disponojnë me pjesën e tyre të pasurisë së trashëguar. Ata menaxhojnë me të dheta tëjetësojnë sipas ligjit, si pasuri e tyre trashëgimore.

Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve, fëmijët e tij si vajzat dhe djemtë dhe bashkëshorti/ja.

Në të gjitha rastet, vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit, trashëgojnë në pjesë të barabarta pjesën e pasurisë trashëgimore

Pra Ti ke të drejta të barabarta me të tjerët, në pasurinë e trashëgimlënësit!

Shtojca 5. Plani i Punës për regjistrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komuna

FUSHATA PËR REGJISTRIM FALAS PËR KOMUNITETET ROM,ASHKALI DHE EGJIPTAS 2015

Artikulli	VEPRIMI I KËRKUAR
Shkresa njoftuese	Përgatitja e draftit të parë të shkresës njoftuese për fushatë
	Miratimi nga Sekretari Përgjithshëm
	Njoftimi i kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës
	Dërgimi nga MAPL-ja tek të gjitha komunat
	Konfirmimi i vizitave në komuna
Materialet promovuese për regjistrimin falas për komunitetet RAE	Përgatitja e draftit / fletëpalosje/banera/bluza
	Miratimi nga Sekretari i Përgjithshëm
	Përzgjedhja e kompanisë
	Fletëpalosje në gjuhën shqipe, 1000 copë
	Fletëpalosje në gjuhën rome, 500 copë
	Fletëpalosje në gjuhën serbe, 400 copë
	Banerë në gjuhën shqipe, 30 copë
	Banerë në gjuhën rome, 15 copë
	Banerë në gjuhën serbe, 10 copë
	Bluza me mbishkrimin “Regjistrohu” në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe rome, 800 copë
Pjesëmarrësit nga Komunitetet	Kryetarë të komunave, drejtorë të drejtorive për administratë, koordinatorë të NJDNJK-së, zyrtarë për komunitete dhe kthim, zyrtarë të gjendjes civile, përfaqësues të lagjeve nga komunitetet RAE dhe përfaqësues të shoqërisë civile gjegjësisht OJQ-të që merren me çështjen e komuniteteve në komuna
	MAPL, Zëvendësministri, Udhëheqësi i DPTK-së, Udhëheqësja e Divizionit për Avancimin e të drejtave të njeriut dhe zyrtarët e DADNJK-së si dhe stafi mbështetës i Zyrës së Zëvendësministrit.
Raportet nga vizitat	Informatë nga vizitat e realizuara
	Raportet nga monitorimi për ecurinë e fushatës
	Përgatitja e draftit të parë të raportit përfundimtar pas 15 marsit, 2015
	Publikimi i informatave dhe raporteve në ueb –faqen e MAPL-së
Mediet	Pjesëmarrja e medieve publike dhe lokale

Shtojca 6. Plani i vizitave

- Identifikimi i personave të paregjistruar në gjendjen civile;
- Promovimi i të drejtave të komuniteteve me theks e drejta për regjistrim të faktit të lindjes dhe regjistrimi i më vonshëm;
- Ofrimi i këshillave dhe krijimi i lehtësirave për regjistrim të më vonshëm në gjendjen civile;
- Pakoja ligjore për të drejtat e njeriut në proces të ndryshimit e hapur për diskutim publik;
- Monitorimi i ecurisë së fushatës dhe grumbullimi i të dhënave;
- Shpërndarja e materialeve promovuese.

Nr	Data	Ora	Dita	Komuna
1	02.02.2015	14:00	E hënë	FUSHË KOSOVË
2	03.02.2015	10:00	E martë	MITROVICË
3	04.02.2015	10: 30	E mërkurë	OBILIQ
4	06.02.2015	10: 00	E premte	FUSHE KOSOVË
5	10.02.2015	10: 30	E martë	FERIZAJ
6	11.02.2015	10: 30	E mërkurë	GJAKOVË
7	13.02.2015	10: 30	E enjte	KAMENICË
8	16.02.2015	10: 00	E hënë	PODUJEVË
9	18.02.2014	10: 00	E mërkurë	GRACANICË
10	19.02.2015	10: 00	E enjte	SUHAREKË
11	20.02.2015	10: 00	E premte	PEJË
12	23.02.2015	10: 00	E hënë	GJILAN
13	24.02.2015	10: 00	E martë	PRIZREN
14	25.02.2015	10: 00	E mërkurë	KLINË
15	26.02.2015	10: 00	E enjte	ISTOG
16	27.02.2015	10: 00	E premte	SKENDERAJ
17	02.03.2015	10: 00	E hënë	SHTIME
18	03.03.2015	10: 00	E martë	LIPJAN
19	04.04.2015	10: 00	E mërkurë	SHTËRPECË
20	05.03.2015	10: 00	E enjte	NOVOBËRDË
21	06.03.2015	10: 00	E premte	VITI
22	10.03.2015	10: 00	E martë	MITROVICË VERIORE
23	11.03.2015	10: 00	E mërkurë	KLLOKOT
24	12.03.2015	10: 00	E enjte	PARTESH
25	13.03.2015	10: 00	E premte	VUSHTRRI

Shënim:

Jo të gjitha komunat janë vizituar sipas agjendës, arsyet i keni të shënuara në tekstin më lartë.

Shtojca 7. Letër njoftuese nga MAPL



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 20 Janar 2015

Për: Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës

Lënda: Lancimi i fushatës për regjistrim falas të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas

Të nderuar kryetarë/e,

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të regjistrimit të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në librat e regjistrimit civil, nga muaji shkurt deri me 15 mars 2015 liron nga pagesa e shërbimeve të gjendjes civile, të gjithë ata që regjistrohen gjatë kësaj periudhe. Kjo bëhet me qëllim të promovimit të drejtave të komuniteteve, sidomos të drejtës së regjistrimit të faktit të lindjes dhe të regjistrimit të mëvonshëm, si segment i rëndësishëm i të drejtave universale të njeriut dhe përmbyshjes së detyrave që dalin nga Plan i Veprimit për Liberalizimin e Vizave për Republikën e Kosovës.

Për të sensibilizuar këtë aktivitet dhe për të maksimalizuar suksesin, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, gjegjësisht Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna, lanson fushatën për regjistrim FALAS për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Angazhimi Juaj bashkë me zyrtarët komunalë përgjegjës në këtë proces është vendimtar.

MAPL, gjatë kësaj periudhe do të vizitojë vendbanimet ku jetojnë komunitetet e lartpërmendura, për të informuar lidhur me rëndësinë e regjistrimit, si dhe do të shpërndajë fletëpalosje dhe materiale të tjera informuese për të drejtat e garantuara.

Bashkangjitur gjeni edhe Letër-Qarkoren e Agjencionit për Regjistrim Civil/ MPB, për mos aplikimin e gjobave dhe të tarifave për shërbime të gjendjes civile për komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Për çdo informata shtesë, mund të na kontaktoni në adresën elektronike: Fakete.kuka@rks-gov.net. Besojmë dhe vlerësojmë se vetëm me bashkëpunimin e ndërsjellë mund t'i realizojmë detyrat dhe obligimet tona ligjore dhe kushtetuese.

Singerisht,
 Besnik Camari

Sekretar i Përgjithshëm, MAPL

Kopje:

Arkivi i MAPL-së;
 Ljubomir Maric, Ministër;
 Agjencionit për Regjistrim Civil ne MPB;
 Zyrës për Regjistrim Civil komunale;
 Koordinatorët e njësisë për të drejtat e njeriut;
 Zyra Komunal për Komunitet dhe Kthim;
 Fakete Kuka, Udhëheqëse e DADNJK/MAPL.

Shtojca 8. Letër qarkore e ARC/MPB



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVO - GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
 AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL - AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU - CIVIL REGISTRATION AGENCY

Num. Nr. 02 Nr. Ser. Nr. 426

Data/Date: 26.03.2014

PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
 MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL
 AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU - CIVIL REGISTRATION AGENCY

DATË/A:	26.03.2014
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Udhëheqësit e Zyrave të Gjendjes Civile
NGA/OD/FROM:	z.Blerim Camaj, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Regjistrim Civil - MPB
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër Qarkore për mos aplikimin e gjobave dhe tarifave për shërbimet në gjendjen civile për Komunitetet-RAE

Të nderuar,

Qeveria e Kosovës përmes Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas (RAE), 2009-2015, Deklaratën e Zagrebit mbi Sigurimin e Dokumenteve të gjendjes civile dhe regjistrimit në Evropën Juglindore, të datës 26 dhe 27 tetor 2011, Drafti i Rishikuar i Deklaratës së Zagrebit në Shkup, Takimi i Dekadës së romëve gjatë marsit 2012, ka theksuar përkushtimin e saj për të siguruar dhe garantuar të drejtat e komuniteteve në përputhje me standardet ndërkombëtare që burojnë nga konventat ndërkombëtare, Kushtetuta e Kosovës dhe legjislacioni vendor për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve.

Qeveria e Kosovës për mes Planit të veprimit në fjalë ka konsideruar se kushtet dhe situata e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas (RAE), në shoqërinë kosovare, kërkon politika dhe veprime të shpejta, konkrete dhe efektive për ta siguruar integrimin e suksesshëm e tri komuniteteve dhe për ta mundësuar kontributin e tyre në shoqërinë kosovare.

Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia e Regjistrimit Civil – QARKORE

1



Kjo fushatë është financuar dhe organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, si dhe është ndihmuar në organizmin e vizitave nga zyrtarët e NJDNJK-ve , strukturave tjera komunale dhe OJQ-ve lokale.



R A P O R T

Fushata për regjistrim FALAS për
komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

20 Janar - 15 Mars 2015